

FUSHAT DHE OBJEKTIVAT	MASA STRATEGJIKE/LEGJISLATIVE/KORNIZA INSTITUCIONALE	ZBATIMI DHE KAPACITETI	PERFORMANCA
<b>1. PROCESI ZGJEDHOR</b>			
<p><b>1.1 Zgjedhjet e lira dhe të ndershme</b></p> <p>Zhvillimi i përgjithshëm i zgjedhjeve</p>	<p>Miratimi i një kornize ligjore që adreson rekomandimet e pazbatuara të OSBE-së përmes një procesi konsultimi të hapur dhe gjithëpërfshirës, brenda vitit 2024 duke adresuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë para ligjit dhe profesionalizmit të administratës zgjedhore. Sigurimi i depolitizimit të komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta;</li> <li>- Votimi i shtetasve shqiptarë me vendbanim të përhershëm jashtë territorit;</li> <li>- Akuzat për blerje të votave dhe keqpërdorimin e administratës qendrore dhe vendore deri në fund të vitit 2024.</li> </ul> <p>Aktet nënligjore detyruese në përputhje me legjislacionin parësor do të miratohen në kohën e duhur brenda vitit 2025.</p>	<p>Rritje e kapaciteteve dhe burimeve të KQZ-së për të përballuar nevojat për të siguruar mbarëvajtjen e duhur të zgjedhjeve në përputhje me legjislacionin e miratuar brenda vitit 2024, duke përfshirë, ndër të tjera, monitorimin e përdorimit përpara zgjedhjeve të burimeve shtetërore.</p> <p>Dixhitalizimi i proceseve të administratës zgjedhore dhe mundësi i votimit elektronik në një shkallë më të gjerë për të siguruar transparencë dhe kontroll më të madh publik mbi zgjedhjet brenda vitit 2025.</p> <p>Zbatimin në kohë të programeve të edukimit të zgjedhësve të përshtatura për kategori të ndryshme votuesish, duke përfshirë programe të edukimit personal të votuesve për romët, egjiptianët, pakicën e tjera kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara gjatë çdo cikli zgjedhor duke filluar nga viti 2025.</p> <p>Autoritetet vendore sigurojnë që të gjithë votuesit të informohen në kohën rreth vendit dhe kohës për shqyrtimin e listës së zgjedhësve dhe vendndodhjes së qendrave të tyre të votimit gjatë çdo cikli zgjedhor duke filluar nga viti 2025.</p> <p>Masat administrative parandaluese janë marrë për të siguruar të dhënat personale të qytetarëve të siguruar në mënyrë të plotë si nga administrata zgjedhore ashtu edhe nga partitë politike në çdo cikël zgjedhor duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025.</p>	<p>Adresimi i rekomandimeve të pazbatuara të raporteve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera, rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe zbatimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.38, datë 09.12.2022.</p> <p>Progres i mëtejshëm në zbatimin efektiv në praktikë të së drejtës së votës nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të rishikuar të garantuar deri në vitin 2025.</p> <p>Transparenca përmes dixhitalizimit dhe procedurave të përmirësuara, avancojnë brenda vitit 2025.</p> <p>Trajtimi i barabartë para ligjit dhe mundësi të barabarta në procesin zgjedhor, përmes mundësisë së grupeve të vulnerabël për të qenë të informuar mbi procesin sigurohet gjithnjë e më shumë brenda vitit 2025.</p>

<p><b>1.2 Media në fushatën zgjedhore</b> (çështje të tjera që lidhen me lirinë e medias në përgjithësi të trajtuara në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit) Ndër të tjera, duhet të merren parasysh: rëndësia e mediave autonome dhe pluraliste, roli vendimtar i transmetuesve të shërbimit publik, ndarja e veprimtarive politike nga interesat mediatike të politikanëve që janë pronarë të medias, mbrojtja e të drejtave hetimore të gazetarëve dhe respektimi i tyre, pavarësia redaksionale, si dhe parandalimi kundër përdorimit të mundshëm të burimeve publike nga qeveritë dhe institucionet publike për të ndikuar në përmbajtjen mediatike.</p>	<p>Ndryshime legjore në Kodin Zgjedhor për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të garantuar mundësi të barabarta për të gjitha palët konkurruese për të pasur qasje në media, përfshirë hapësirën reklamuese dhe adresimin e mbulimit të fushatës mediatike me materiale të gatshëm të ofruar nga partitë, duke përfshirë monitorimin e mediave sociale të miratuar brenda vitit 2024, pas një procesi konsultimi publik.</li> </ul>	<p>Rritja e monitorimit dhe profesionalizmit sasior dhe cilësor në raportimin mediatik (duke përfshirë materiale të gatshme nga partitë politike) të medias gjatë fushatës zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, si dhe kapacitetet e AMA-s për të kryer monitorimin në mënyrën e duhur, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, nëpërmjet zbatimit të “Modernizimit të studios së monitorimit” nga AMA.</p> <p>Angazhimi institucional në shënjestrimin e dezinformimit gjatë proceseve zgjedhore në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025, duke përfshirë target grupet përkatëse</p>	<p>Ekziston një sistem efektiv i monitorimit cilësor dhe sasior të medias dhe dispozitave politikisht neutrale të mbulimit mediatik gjatë gjithë zgjedhjeve, dhe është vendosur zbatimi i sanksioneve bindëse dhe funksionale brenda vitit 2027.</p> <p>Rreziqet e dezinformimit zbuten gjithnjë e më shumë përmes masave të synuara nga KQZ-ja dhe AMA brenda vitit 2030.</p> <p>Adresimi i rekomandimeve të pazbatuara të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera</p>
<p><b>1.3 Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore</b> Kriteret për financimin publik dhe privat të partive politike; rregullat për donacionet private dhe shpenzimet e lidhura me fushatat zgjedhore; Transparenca e llogarive; mekanizmat e mbikëqyrjes dhe monitorimit të pavarur, duke përfshirë sanksione domethënëse efektive, proporcionale dhe bindëse për shkeljet.</p>	<p>Kuadri ligjor për financimin e partive politike në përputhje me rekomandimet e OSBE-së i miratuar brenda vitit 2024, duke përfshirë, ndër të tjera, zgjerimin e rregulloreve dhe kufizimeve për donacionet dhe shpenzimet për palët e treta, si dhe zbulimin para zgjedhjeve.</p>	<p>Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare të KQZ-së për të zbatuar në mënyrë efektive kërkesat ligjore në lidhje me mbikëqyrjen dhe monitorimin e financave të fushatës brenda vitit 2025.</p> <p>Procesi i financimit të partive politike/raportimit online të partive politike, audituesve dhe monitoruesve dixhitalizohet gjithnjë e më shumë për të mundësuar raportimin e shpejtë online dhe garantimin e transparencës në kohë reale mbi të ardhurat dhe shpenzimet në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga viti 2025.</p>	<p>Adresimi i rekomandimeve të pazbatuara të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe zgjedhjet e tjera.</p> <p>Auditimi mbi financimin e partive politike përmes krijimit të portalit të financimit forcohet ndjeshëm brenda vitit 2025 .</p> <p>Sanksionet zbatohen efektivisht në rastet e shkeljeve të dispozitave për financimin e partive politike në çdo cikël zgjedhor, duke filluar nga zgjedhjet e vitit 2025.</p>
<p><b>2. FUNKSIONIMI I KUVENDIT</b> <i>Funksionimi i Kuvendit duhet të bazohet ne parimet e transparencës, integritetit dhe efektivitetit</i></p>			

<p><b>2.1 Transparenca dhe llogaridhënia</b> Shkalla e transparencës së punës parlamentare; Aspektet horizontale (ndërinstitucionale) dhe vertikale (qytetarët) të llogaridhënies së Kuvendit</p>	<p>-Amendimi i Kodit të Sjelljes së deputetëve, për të futur detyrimin që takimet e deputetëve dhe stafit të tyre me OSHC-të dhe lobistët të zhvillohen vetëm me ata që janë të regjistruar në Regjistrin e Transparencës në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Komisionit të datës 31 janar 2018 mbi Kodin e Sjelljes për Anëtarët e Komisionit Evropian, neni. 7 si dhe publikimin e procesverbalit të mbledhjes deri më 2029.</p> <p>-Ndryshimi i Rregullores së Kuvendit për të zgjaruar zbatimin e Post Kontrollit të ligjshmërisë jo vetëm për ligjet e përafuara me acquis të BE-së, por edhe në aktet normative që kanë fuqinë e ligjit deri në vitin 2026.</p>	<p>Kapacitetet e deputetëve për të përmirësuar llogaridhënien përmes sesioneve informuese, legjislativë, kontrolluese dhe monitoruese të qeverisë dhe institucioneve të pavarur rriten përmes veprimtarive të vazhdueshme të përmirësimit të aftësive.</p> <p>-Hartimi i draft metodologjisë për shqyrtimin e post-kontrollit ligjor me mbështetjen e Fondacionit Westminster në bashkëpunim me stafin e Kuvendit dhe trajnimin e stafit të Kuvendit për zbatimin e saj (Afati: 2024-2026);</p> <p>-Disponueshmëri më në kohë dhe më miqësore për përdoruesit e dokumentacionit zyrtar parlamentar për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë duke përmirësuar vazhdimisht informacionin e publikuar në faqen e Kuvendit në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit (Afati i fundit : 2024-2030).</p> <p>- Zbatimi i një sistemi transkriptimi që të mundësojë sqarimin sa më të shpejtë të materialit audio për mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare sa më shpejtë të jetë e mundur (2024-2030).</p> <p>-Transmetim i vazhdueshëm në kohë reale dhe qasje në materialet audio-video të veprimtarisë parlamentare në çdo kohë nga publiku; (RTSH Kuvendi, Faqja e Kuvendit dhe Rrjetet Sociale të Kuvendit) (Afati: 2024-2030).</p> <p>-Hartimi i një plani pune për arritjen e standardeve dhe treguesve të transparencës 2024-2025.</p> <p>-Zbatimi i sistemit E-Legjislacion që do të integrojë sistemet e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin ligjvënës si dhe fuqizimin e</p>	<p>Përfshirja e aktorëve më të gjerë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit në punën e Kuvendit përmirësohet dhe forcohet brenda vitit 2030. Kodi i Sjelljes ndryshohet dhe zbatohet nga deputetët.</p> <p>Rregullorja e Kuvendit ndryshohet dhe kontrolli post ligjor zbatohet jo vetëm për ligjet e përafuara me acquis të BE-së por edhe për aktet normative që kanë fuqinë e ligjit deri në vitin 2027</p> <p>Disponueshmëria e dokumentacionit zyrtar parlamentar për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë në zbatohet në kohën e duhur dhe me qasje miqësore për përdoruesit.</p> <p>Transmetim në kohë reale dhe akses në materialet audio-video të veprimtarisë parlamentare në çdo kohë nga publiku.</p> <p>Standardet dhe treguesit e theksuar në dokumentin e transparencës të zbatohen plotësisht deri në vitin 2030.</p> <p>Procedura legjislativë më të shpejta dhe efektive të mundësuar përmes dixhitalizimit dhe përmirësimit të proceseve të brendshme brenda vitit 2030 dhe fuqizimit të kapaciteteve administrative të Kuvendit me synimin për të përballuar rritjen e përgjegjësisë për çështjet e transparencës që</p>
---	---	--	---

		<p>kapaciteteve administrative të Kuvendit nëpërmjet trajnimeve për përballimin e përgjegjësi ve të shtuara për çështjet e transparencës që dalin nga procesi i anëtarësimit brenda vitit 2030.</p> <p>-Rritja e pjesëmarrjes së OSHC-ve dhe grupeve të interesit në mbledhjet e komisioneve parlamentare gjatë procesit ligjberës dhe mbikëqyrës si dhe gjatë ushtrimit të funksionit zgjedhor të Kuvendit. (Afati i fundit: 2024-2030).</p> <p>-Rritja e numrit të projektligjeve të konsultuara në platformën e projektligjeve në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. (Afati i fundit: 2024-2030).</p> <p>-Rritja e përfshirjes së OSHC-ve dhe grupeve të interesit në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian duke u dhënë atyre më shumë hapësirë/kohë gjatë diskutimeve në mbledhjet e KKIE-së duke diskutuar zbatimin e rekomandimeve të dokumenteve të KE-së si: Raportet Vjetore, Raportet e shqyrtimit, standardet e hapjes/ndërmjetme/mbylljes etj. dhe gjithashtu dokumente të përgatitura nga institucionet shqiptare në përgjigje të tyre si udhërrëfyes, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian, Plani Kombëtar për Procesin e Aderimit etj. (Afati: 2024-2023).</p> <p>- Përmirësimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi ekzekutivin duke shtuar përdorimin e instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seanca dëgjimore në komisionet parlamentare, mocione, vizita, etj.) si dhe duke rritur aktivitetet e nënkomisioneve parlamentare. Afati: 2023-2030</p> <p>- Organizimi i proceseve të zgjedhjeve/emërimeve të kryetarëve dhe anëtarëve të institucioneve të</p>	<p>dalin nga procesi i anëtarësimit brenda viteve 2024 -2030.</p> <p>Përfshirja e aktorëve më të gjerë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit në punën e Kuvendit përmirësohet dhe forcohet brenda vitit 2030.</p> <p>Rritja e numrit të projektligjeve të konsultuara përmes platformës për konsultimin e projektligjeve.</p> <p>Shkëmbim kuptimplotë me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe grupet e interesit gjatë takimeve të KKIE duke diskutuar dokumente të ndryshme.</p>
--	--	---	--

		<p>pavarura sipas afateve ligjore dhe vendeve vakante të krijuara, pa vonesa dhe duke siguruar zbatimin e parimeve të paanshmërisë, pavarësisë dhe transparencës. Afati: 2024-2030.</p> <p>- Ushtrimi sistematik i funksionit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj veprimtarisë së qeverisë, lidhur me zbatimin e ligjeve dhe politikave, nëpërmjet: Përdorimit më intensiv të interpelancave, pyetjeve, mocioneve për debat në seancat plenare, seancave dëgjimore në komisionet parlamentare, kërkesave për informacion, etj. (Afati: 2024-2030)</p> <p>- Rritja e përdorimit të instrumenteve të kontrollit nga deputetët (pyetje, interpelanca, seanca, mocione, vizita, etj.) (Afati: 2024-2030)</p> <p>-Zhvillimi i takimeve të përbashkëta periodike ndërmjet Parlamentit, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura për të diskutuar dhe mbikëqyrur nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga institucionet e pavarura (Afati: 2024-2030).</p> <p>-Forcimi i rolit monitorues ndaj institucioneve të pavarura përmes organizimit të seancave dëgjimore në komisionet parlamentare me institucione të pavarura duke mos shfrytëzuar raportet e dërguara nga institucionet e pavarura për çështje të ndryshme (Afati: 2024-2023).</p> <p>-Shqyrtimi nga Kuvendi/Komisionet e Përhershme Parlamentare të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, duke zbatuar procedurat ligjore dhe afatet për raportim në Kuvend (Rregullorja e Kuvendit (neni 103) dhe ligjet organike që përcaktojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve) dhe miratimin e një rezolute për secilën prej tyre me rekomandime specifike që duhen ndjekur dhe zbatuar për vitin në vijim/ (Afati: 2024-2030).</p>	<p>Një rol proaktiv dhe i zgjeruar i Kuvendit për të mbikëqyrur punën e qeverisë.</p> <p>Zgjedhja/Emërimi i kryetarëve dhe anëtarëve të institucioneve të pavarura sipas afateve ligjore dhe vendeve vakante të krijuara.</p>
--	--	---	---

			Një rol proaktiv dhe i zgjeruar i Kuvendit për të kontrolluar punën e qeverisë, për të monitoruar institucionin e pavarur dhe për të mbikëqyrur nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.
<p><b>2.2 Integriteti</b></p> <p>Kodet etike; deklarimin e pasurisë; regjimet për parandalimin e konfliktit të interesit; kufijtë e imunitetit nga hetimi, ndjekja penale ose gjykimi i veprave të korrupsionit në shkallën e nevojshme në një shoqëri demokratike.</p>	<p>Sigurimi i harmonizimit të plotë me standardet ndërkombëtare për luftimin e ryshfetit të zyrtarëve të huaj publikë nëpërmjet ratifikimit të Konventës së OECD-së për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet e Biznesit Ndërkombëtar të 17 dhjetorit 1997 brenda 2027.</p>	<p>Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të Kuvendit për mbështetjen e deputetëve në tema të konfliktit të interesave, çështjeve etike, korrupsionimit të legjislacionit etj.</p> <p>Kapaciteti i Kuvendit për të siguruar korrigjimin e duhur të legjislacionit për korrupsionin brenda vitit 2027.</p> <p>-Zbatimi i Kodit të Sjelljes për deputetët nëpërmjet caktimit të masave disiplinore në rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit në komisione dhe seanca plenare (Afati: 2024-2030).</p> <p>-Organizimi i sesioneve informuese me deputetët e rinj për çdo legjislaturë të re për zbatimin e Kodit të Etikës apo çështjet etike dhe duke u ofruar këshilla të vazhdueshme për çështjet e konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si deputetë (Afati: 2024-2030).</p> <p>-Finalizimi i draft metodologjisë për identifikimin e rrezikut për korrupsion në procesin ligjberës të zhvilluar me mbështetjen e ekspertëve të Westminster Foundation në bashkëpunim dhe trajnimin e stafit të Kuvendit për zbatimin e tij (Afati: 2024-2025);</p> <p>-Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të Kuvendit për mbështetjen e deputetëve në tema për konflikt interesash, çështje etike etj. (Afati 2024-2030).</p>	<p>Standarde më të larta etike dhe integriteti punimet e Kuvendit janë përmirësuar në mënyrë progresive deri në vitin 2030.</p> <p>Identifikimi i rrezikut për korrupsion në procesin ligjberës si një nga elementët e opinioneve të shërbimit ligjor për deputetët. (Afati 2026-2030)</p> <p>Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit për mbështetjen e deputetëve në tema të konfliktit të interesit, çështjeve etike, korrupsionimit të legjislacionit etj. (Afati 2024-2030).</p>

<p><b>2.3 Efektiviteti</b> Organizimi i përgjithshëm i biznesit brenda parlamenteve dhe se si ai është në përputhje me normat dhe vlerat demokratike. Në veçanti, kryerja efektive e funksioneve legjislative dhe të kontrollit; roli i mazhorancës dhe opozitës; gjithëpërfshirjen e funksioneve ligjberëse, duke përfshirë rolin e palëve të interesuara. - Ndryshimi i kuadrit ligjor 1 vit përpara aderimit për të përfshirë koncepte si marrëdhëniet mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit Europian, parimi i subsidiaritit në përputhje me Rregulloren e Punës së Parlamentit Europian.</p>	<p>-Ndryshime Kushtetuese që garantojnë respektimin e parimit të epërsisë së ligjit të BE-së ndaj të gjitha dispozitave të kundërta të ligjit kombëtar, nga institucionet demokratike, përfshirë Kuvendin, Qeverinë, autoritetet gjyqësore, dhe Gjykatën Kushtetuese brenda 6 muajsh para anëtarësimit.</p> <p>- Ndryshimi i nenit 28 të ligjit për Avokatin e Popullit, për heqjen e detyrimit për publikimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit pas prezantimit të tij në Kuvend deri në vitin 2026.</p>	<p>Sistemi i e-Legjislacionit që do të integrojë sistemet e të gjitha institucioneve të përfshira. në procesin ligjberës zbatohet brenda vitit 2030.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve të stafit administrativ dhe politik të Kuvendit në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për mbështetjen e deputetëve, për të përballuar detyrimet e shtuara që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit brenda vitit 2030.</p>	<p>Koncepte të tilla si marrëdhëniet mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Parlamentit Europian dhe parimi i subsidiaritit në përputhje me Rregulloren e Punës të Parlamentit Europian.</p> <p>Parimi i supremacisë së ligjit të BE-së është pjesë e dispozitave të Kushtetutës.</p> <p>Procedura legjislative më të shpejta dhe efektive të mundësuar përmes dixhitalizimit dhe përmirësimit të proceseve të brendshme brenda vitit 2030</p> <p>Është përmirësuar cilësia e shërbimeve të ofruara për MSHP nga stafi administrativ dhe politik për të përballuar detyrimet e shtuara që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit brenda vitit 2030.</p> <p>Raporti vjetor i Avokatit të Popullit publikohet para se të prezantohet në Kuvend.</p>
--	---	--	--

**3. ROLI I SHOQERISE CIVILE**  
*Kuadri ligjor kombëtar, rregullues dhe politik për veprimtarinë e OSHC-ve duke përfshirë (kushtet e rregjistrimit, taksimit, mekanizmave konsultues etj.) dhe konteksti politik për të siguruar dhe bërë funksional një mjedis mundësues me shoqëri civile.*

<p><b>3.1 Kuadri ligjor rreth shoqërisë civile</b>  Kuadri ligjor, politik dhe institucional, pajtueshmëria me instrumentet dhe standardet përkatëse ndërkombëtare, strategjitë publike për të promovuar hapësirën qytetare dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për zbatimin dhe fuqizimin e kapaciteteve, funksionimin dhe performancën, sfidat dhe mangësitë</p>	<p>Korniza legislative për Këshillin Kombëtar ndryshohet për të përmirësuar funksionimin e tij dhe për të siguruar përfshirje më të madhe të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile brenda vitit 2026.</p> <p>Bashkëpunimi i institucionalizuar ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile dhe sigurimi i pjesëmarrjes kuptimplote të OSHC-ve në proceset vendimmarrëse, duke përfshirë në kontekstin e negociatave të anëtarësimit në BE, përmirësohet përmes miratimit dhe monitorimit të një udhërrëfyese të ri brenda vitit 2024.</p> <p>Miratimi i raportit të vlerësimit të monitorimit për udhërrëfyesein 2019-2023 për krijimin e një mjedisi të favorshëm për OSHC-të brenda vitit 2024.</p> <p>Miratimi i Udhërrëfyeseit të ri për mjedisin mundësues për OSHC-të 2024-2027 brenda vitit 2024.</p>	<p>Rritja e kapaciteteve të mekanizmit monitorues të udhërrëfyeseit të miratuar për një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile brenda vitit 2024.</p> <p>Procedurat administrative të procesit të dhënies së granteve të AMSHC do të përmirësohen brenda vitit 2025.</p> <p>Funksionaliteti i plotë i platformës online për ndjekjen e procesit të granteve është do të aktivizohet brenda vitit 2025.</p>	<p>Puna e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile forcohet duke mundësuar shprehjen më të mirë të prioriteteve të OSHC-ve në proceset e politikëbërjes.</p> <p>OSHC-të marrin mbështetje përmes fondeve shtetërore, e mundësuar nga procedura të shpejta dhe të përmirësuara brenda vitit 2030.</p>
<p><b>3.2 Kornizat kombëtare ligjore, rregullatore dhe politike për organizatat e shoqërisë civile (OSHC)</b></p> <p>Kjo përfshin kushtet për regjistrim, zbatimin e lirisë së asociimit, mekanizmat për parandalimin e ndërhyrjeve dhe presionit të panevojshëm mbi aktivitetet dhe anëtarët e OSHC-ve, kushtet për taksimin dhe</p>		<p>Regjistri elektronik i OSHC-ve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është funksional brenda vitit 2023.</p> <p>Ka kapacitetet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të siguruar funksionimin e sistemit dixhital për regjistrimin e OSHC-ve brenda vitit 2023.</p> <p>U rritën kapacitetet e organeve tatimore për të përballuar nevojën për të mundësuar procedura të shpejta të rimbursimit të TVSH-së.</p>	<p>Sigurohet transparencë dhe kontroll më i madh publik mbi statusin dhe anëtarësimin e OSHC-ve brenda vitit 2025.</p> <p>Rimbursimi i tatimit mbi vlerën e shtuar është rritur ndjeshëm në praktikë përmes një procesi të shpejtë aplikimi brenda vitit 2025.</p>



<p>aksesin në financim/burime, etj. zbatimi dhe kapaciteti zbatues, sfidat dhe boshllëqet.</p>			
<p><b>3.3 Konteksti më i gjerë për një mjedisi mundësues</b></p> <p>Kuadri ligjor, politik dhe institucional, përputhshmëria me instrumentet dhe standardet përkatëse ndërkombëtare, kapaciteti zbatues dhe zbatues, funksionimi dhe performanca, sfidat dhe mangësitë. Kjo përfshin mënyrën se si sistemi siguron pjesëmarrje efektive në hartimin e politikave për OSHC-të dhe qytetarët, publiku llogaridhënia, mekanizmat e konsultimit, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve publike dhe funksionimi i strukturave/këshillave të dialogut shtet-OSHC.</p>	<p>Korniza ligjore e rishikuar për vullnetarizmin miratuar brenda vitit 2027.</p> <p>Metodologjia e akteve që i nënshtrohen konsultimeve publike është rishikuar dhe miratuar brenda vitit 2025 duke zgjeruar fushën e konsultimit publik për aktet e qeverisë.</p> <p>Ndryshim në ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, dhe në legjislacionin dytësor për konsultimin publik bëhet në mënyrë progresive drejt vitit 2030.</p> <p>-Rritja e cilësisë së raporteve të konsultimit publik dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse me staf të përgatitur dhe të mirëtrajnuar për të zgjeruar deri në vitin 2030 procesin e konsultimit publik në legjislacionin dytësor me interes të lartë publik nëse plotësohen kushtet e mësipërme.</p>	<p>Rriten kapacitetet e ministrive të linjës për të kryer konsultimet e duhura brenda vitit 2025.</p> <p>Mjetet dixhitale për të siguruar një konsultim më të madh publik të duhur brenda vitit 2025.</p> <p>Rritja e cilësisë së raporteve të konsultimit publik dhe plotësimi i strukturave përgjegjëse me staf të përgatitur dhe të mirëtrajnuar, me qëllim zgjerimin e procesit të konsultimit publik deri në vitin 2030 edhe në legjislacionin dytësor me interes të lartë publik nëse plotësohen kushtet e mësipërme.</p>	<p>Cilësia e konsultimeve, transparenca dhe pjesëmarrja publike e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse u përmirësuan brenda vitit 2025.</p> <p>Forcimi i kulturës pjesëmarrëse të publikut dhe palëve të interesuara dhe rritja e llogaridhënies së institucioneve në vendimmarrje përmes konsultimit publik që çon në rregullime më të mira brenda 2026</p> <p>Administrata publike në Qendrën e Qeverisë është e aftë të kryejë procesin e konsultimit publik bazuar në standardet më të larta - të vazhdueshme.</p>